



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 67, datë 09.02.2023

**PËR
NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR
VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR NË PROVIMIN E PRANIMIT NË
PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR KANCELAR DHE/OSE PËR NDIHMËS LIGJOR PËR VITIN AKADEMIK 2023-
2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 59, pika 3, germa “e”, nenin 62, pika 14, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 53, pikat 4/b dhe 9, të Ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin nr.424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024 (në vijim Komisioni i Përkohshëm).
2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar, të cilët zgjidhen pas zhvillimit të procedurës së shortit. Kryetari i Komisionit të Përkohshëm caktohet nga Kryetari i Këshillit.
3. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm, bazuar në pikën 2 të këtij vendimi është:
 1. Z. Dritan Hallunaj;
 2. Z. Ridvan Hado;
 3. Z. Ilir Rusi.
4. Komisioni i Përkohshëm merr masat për përmbushjen e detyrës së tij bazuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në Vendimin nr.424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR